

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ish-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/25/ish-shefja-e-shish-nuk-shantazhoi-median-por-kercenoi-armiqte-e-saj/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 18:13:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 18:00:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	eb101f24684f0be49a65d9f88f3eb5fea476611734a1ee0ea3e1c9a7cfd6e1b2
TEKSTI	1055df13dcf84c2c17327c798d10edb3cf82d9045bdf74bce92bd765a99cda57
PAMJA	d99e3b8a01589f92f8fb2ec7c5d33b1ad4e20363a2a745176e52eeb9f2275514

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	62b60a8aa7a880d7beb0d85046cf78e909cf27f30336b09d32e98d83a9c7dd76
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b795f32e8dcca3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/62b60a8aa7a880d7beb0d85046cf78e909cf27f30336b09d32e98d83a9c7dd76>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ish-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

Kryesore

Publikuar: 25/09/2026

f X

**Nga Lorenc Vangjeli**

Ish-shefja e SHISH Vlora Hyseni u duk sikur u tradhtua nga nervat kur përmendi dy togfjalësh fatalë: “Agjentë serbë e dhomë hoteli”. Pra, jo vetëm tradhti kombëtare si shërbesë, por edhe seks i ndaluar si shpërblësë. U duk gjithashtu edhe si një mënyrë gazmore e mendjelehtë për të relativizuar raportin e saj të mundshëm me të pandehurin e famshëm të dosjes që e ka mbërthyer brenda saj.

“Më akuzojnë mua, por dhe ju jeni njëlloj!”. E parë kështu, shpjegimi është shumë sipërfaqësor, padyshim naiv dhe shumë banal për t’u gjykuar si shkarje e gojës që shket meqë nuk puth dot më. Në të kundërt, ajo ishte një fjali krejtësisht e mirëllogaritur. Shantazhi i konsumuar publikisht nuk kishte në shënjestër gazetaren e njohur të kronikës. Reporterja ishte vetëm mikrofoni të cilën zonja Hyseni e përdori për të paralajmëruar luftë, hakmarrje dhe për të kërcënuar “listën e gjatë të armiqve që i kishin bërë gjëmën “çiftit”. Ishte njëkohësisht edhe një ofertë e dëshpëruar për te shpëtuar çfarë mundet nga gërmadha penale e morale që i është shembur mbi kokë: Më mbani mbi gropë, ndryshe humnera ju pret edhe juve!

Rrënimi i frikshëm i zonjës Hyseni në vetëm 48 orë dramatike dhe ekspozimi i mesazheve personale të saj me zotin Agasi, është vetëm një episod kulmor dhe i pabesueshëm në një botë të çmendur shqiptare ku të gjithë kanë sekretet e tyre: jo vetëm komunikim me kontakte minimalisht të papërshtatshëm, por edhe mëkate penale, pislloqe njerëzore apo edhe dobësi porno-erotike. Zonja e sekreteve paralajmëroi si paradhënie pikërisht këto thembra Akili, ku shumëkush në Tiranë çalon rëndë. Paralajmëroi dalje në dritë të këtyre “sekreteve” publikë, që i dinë të gjithë.

Një drejtues disa vjetra më parë kërkimi padyshim që ka nështetur e

Me të lexuarat

- Skandali/ Shefin e Komisarit të Fushë-Krujës Elton Shahinin e rrahin me shupllë në mes të rrugës**
- Gazim Bregu që ndërtoi vilën e Ahmetajt në Hamallaj, përfitoi 20 milionë euro nga vdekja e...**
- arrestua në Rusi, zbulohet portreti i Shpëtim Aliut! ('Kumbari' që furnizonte... Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të...**
- Erois Agasi, Grupi Kriminal i AKSHI-t hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e Rry...**

një drejtues i asaj vjeçari shërbimit padyshim që ka pasur informacionit. Është gjithashtu edhe dëshmitar i dobësive të njerëzve të pushtetshëm në Tiranë. Kur edhe një amator në këtë punë si Agasi, ka tmerruar dynjanë me serinë e regjistrimeve të fshehta që ju kishte bërë “mysafirëve” në zyrën e tij e gjetkë, është e lehtë të imagjinohet se çfarë mund të ketë pasur në kasafortë zonja Hyseni që kishte një ushtri shtetërore informatorësh në dispozicion.

Në zyrën e zotit Agasi ne ish-Blllok, në vilën në një resort në periferi të Tiranës apo dhe në një zonë rezidenciale në plazhin e Durrësit, ka parakaluar një armatë e palavdishme shqiptarësh të pushtetshëm. Mes tyre edhe ministra, deputetë të shumtë të majtë e ca më pak edhe të djathtë, gjyqtarë e prokurorë, drejtues të lartë të policisë, njerëz të rëndësishëm të medias, biznesmenë shumë të njohur që mund të kenë pasur nevojë për forcën e armëve e të tjerë që nëpërmjet armëve si zanat, ishin shndërruar në biznesmenë.

Kontaktet me Agasin në atë kohë ishin një aset, një mundësi për karrierë në pushtet e biznes, një shans për të zgjidhur probleme, për të qenë pjesë aleancash fluide e për të ndryshuar raporte forcash. Madje edhe brenda partisë që qeveris vendin e kryesisht brenda saj. “Çifti” që shkëmbente pasion, përkushtim e interesa okulte, padyshim që ka shkëmbyer edhe informacione të tilla. Sikur edhe kaq të kishte në dispozicion zonja Hyseni, subjektet e këtyre përgjimeve kanë të drejtën e Zotit t’u priset gjumi për shumë kohë. Dhe meqë ish-shefja e shërbimit përmendi dhomat në hotele, pa gjumë do të mbeten edhe ata kanë gdhirë netë të bardha, po shumë të bardha, në periferi të Tiranës, në vila luksi të harbuar e në shoqërinë e një listë mbresëlënëse me eskorta shëtitëse VIP. Të cilat prej kohësh, një pjesë të mikpritësve të tyre, i kanë shndërruar në barcaleta pa shumë kripë me dashnorët e rinj.

Fatmirësisht dy prokurorët e dosjes, Altin Dumani dhe Bledar Maksuti dhe së paku një numër mbresëlënëse agjentësh të BKH-së, nuk janë në këtë listë. Dhe së paku deri më tani, si përfaqësues të akuzës publike, i kanë të dyshuarit e tyre me hakmarrjen e shtetit në gjykatë.

Ndaj fjalë arrogante dhe brutale që zonja Hyseni derdhi mbi gazetaren Lala, në fakt është një breshëri mitralozi e shkrehur në ajër pikërisht mbi kokat e kësaj turme laramane individësh. Të cilët i bashkon pushteti, paraja, vaniteti, krimi dhe përshtatja me rregullat e liga të stabilizuara për të pasur sukses. Tani e më tej, ata i bën njësh edhe frika nga e nesërmja e panjohur.

Ish-shefja e SHISH nuk hapi kutinë e Pandorës. Ajo dëshmoi se ka password-in e saj. Paralajmëroi se së paku mund të prishë gazin e atyre që kanë nisur festën për rrënimin e saj. Madje edhe shumë më shumë se kaq, zonja Hyseni duket se paralajmëron edhe hakmarrjen e të mbyturit që mbyt. Njëlloj siç premtonte në

mesazhet e saj plot nënkuptime: “Me kanë bërë shumë gjëra, e

mesazhet e saj plot për kushtimin. “Na kanë bërë shumë gjera, u shpirt! Dua që ata të paguajnë!”.

TAG:

Lorenc vangjeli

Të ngjashme



Grupi kriminal i AKSHI-t hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e Rrytajve), si po sfidohet SPAK dhe shqiptarët me kësh...

Skandali/ Shefin e Komisarariatit të Fushë-Krujës Elton Shahinin e rrahin me shpulla në mes të rrugës në Durrës

Kush është Gazim Bregu që ndërtoi vilën e Ahmetajt në Hamallaj, përfitoi 20 milionë euro nga rindërtimi, aferat e pandëshkuar e Tigris 23 milionë e...

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.